

Pasqyrat financiare

Kredo Finance sh.p.k

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur	Faqe i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e Flukseve të Parasë	4
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	5-25

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Aksionarët dhe Drejtimin e Kredo Finance Sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Kredo Finance Sh.p.k (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në Lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencat auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurën të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojme me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Hledium Kodva, FCCA

Grant Thornton sh.p.k.


Tiranë, Shqipëri
26 mars 2018



Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2017
Aktivet		
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	6	10,314,464
Kërkesa të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	7	1,970,989
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	8	9,068,647
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	9	8,394,533
Totali i aktiveve		29,748,633
Detyrimet dhe kapitali		
Detyrime		
Llogari të pagueshme	10	1,342,339
Detyrime tatimore	11	1,676,097
Hua	12	12,724,184
Totali i detyrimeve		15,742,620
Kapitali		
Kapitali i paguar	13	36,315,880
Humbje e vitit		(22,309,867)
Totali i kapitalit		14,006,013
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		29,748,633

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për periudhën e mbyllur me 31 dhjetor 2017 u aprovuan nga administratori dhe u nënshkruan si më poshtë:


Arlinda Muja
Administratore



Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-25 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse

	Shënime	31 dhjetor 2017
Te ardhura (shpenzime) neto nga interesat		
Të ardhura nga interesat	14	-
Shpenzime për interesa	14	(1,125,001)
Totali i të ardhurave (shpenzimeve) neto nga interesat		(1,125,001)
Shpenzime operative		
Shpenzime amortizimi	8, 9	(257,755)
Shpenzime personeli	15	(10,808,032)
Shpenzime të tjera operative	16	(9,939,130)
Humbje neto nga kursi i këmbimit	17	(179,949)
Totali i shpenzimeve operative		(21,184,866)
Humbja para tatimit		(22,309,867)
Tatimi mbi fitimin		-
Humbja evitit		(22,309,867)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-25 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



2

Pasqyrat e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali	Humbja e mbartur	Totali
Gjendja me 28 mars 2017			
Kapitali fillestar i paguar	15,000,000	-	15,000,000
Shtesë kapitali	21,315,880	-	21,315,880
Humbja e vitit	-	(22,309,867)	(22,309,867)
Gjendja me 31 dhjetor 2017	36,315,880	(22,309,867)	14,006,013


Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-25 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



Pasqyra e Flukseve të Parasë

	Shënime	31 dhjetor 2017
Flukse monetare nga aktiviteti operativ:		
Fitimi per vitin		(22,309,867)
<i>Regullimet për:</i>		
Amortizimin	8, 9	257,755
Shpenzime për interesa	14	1,125,001
Fluksi neto nga aktiviteti i shfrytëzimit para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit		(20,927,111)
Ndryshimet e aktiveve dhe detyrimeve të shfrytëzimit:		
(Rritje/ rënie e kërkesave të arkëtueshme	7	(1,970,989)
Rritje/ (rënie) e detyrimeve ndaj furnitorëve	10	1,342,339
Rritje/ (rënie) e detyrimeve tatimore	11	1,676,097
Interesi i paguar		(799,917)
Flukse monetare (të përdorura në) nga aktivitetet operative		(20,679,581)
Flukse monetare nga aktivitet investuese:		
Blerje të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	8	(9,326,402)
Blerje të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara	9	(8,394,533)
Flukset e arkës (të përdorura në) nga aktivitetet investuese		(17,720,935)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Huamarrje	12	12,399,100
Rritje kapitali		36,315,880
Flukset monetare neto nga aktivitetet financiare		48,714,980
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre më 28 mars		-
Ndryshimet në mjetet monetare dhe ekuivalent e tyre më 31 dhjetor		10,314,464
Mjete monetare dhe ekuivalent e tyre më 31 dhjetor	6	10,314,464

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-25 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



4